28 nëntor 2012

HISTORIA E VENDOSJES SË BUSTIT TË SKËNDERBEUT NË LONDËR

PROLOG

E fillova punën si i Ngarkuar me Punë i shtetit shqiptar dhe, një vit më vonë, si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë në Ambasadën e Shqipërisë në Londër, më 17 shkurt 2012 – në Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Objektivi më i rëndësishëm që i kisha vënë vetes, në atë vit të përvjetorit të njëqindtë të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ishte vendosja në Londër e një busti të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit – Skënderbeut – një ëndërr e kahershme e shqiptarëve në ishullin britanik.

Biseda me Kryeministrin dhe Ministrin e Kulturës për vendosjen e Bustit në Londër.

Para se të merresha me procedurat e vendosjes së atij busti në Londër, e bisedova çështjen me Kryeministrin Shqiptar, Dr. Sali Berisha. I thashë se i kisha vënë objektiv vetes që të vendosnim bustin e Skënderbeut në Londër, gjë të cilën e mirëpriti dhe u angazhua ta mbështeste me çdo mundësi që kishte shteti

shqiptar. Nuk vonoi shumë dhe Londrën e vizitoi në një Forum Ekonomiko - Kulturor të organizuar nga International Business and Diplomatic Exhange (IBDE) Ministri i Kulturës i atëhershm. Biseda për vendosjen e bustit të Skënderbeut ishte ajo që na mori më shumë kohë gjatë një dite kur po pinim një kafe ngjitur me Katedralen e Shën Palit. Kuptohet që Ministri i Kulturës ishte plotësishit i interesuar, sado që vura re nota skepticizmi për shkak të vështirësisë së madhe, që paraqiste një sipërmarrje e tillë në çdo aspekt. Por edhe ai ishte shumë pozitiv dhe më premtoi ndihmën e tij për realizimin e një projekti të tillë.

Retrospektive - Përpjekjet e mëparshme për vendosjen e bustit të Skënderbeut në Londër

Në morinë e gjërave që mora në dorëzim në zyrën e Ambasadorit shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar ishte edhe një dosje ku pasqyroheshin përpjekjet e bëra deri atëherë për vendosjen e një monumenti të Skënderbeut në Londër. Ishte një korrespondencë midis Ambasadorit shqiptar, paraardhësi im i viteve

’90, zotit Pavli Qesku, me një patriot shqiptar, i cili i kishte kushtuar aq shumë punë, mundime dhe përpjekje një misioni të tillë. Fjala është për z. Astrit Leka, i cili ka arritur të vendosë Bustin e Skënderbeut në Gjenevë. Ai këmbeu letra edhe me zyrën e Kryeministrit Tony Blair, por pa arritur që t’i bindte autoritetet londineze, që një bust të tillë ta vendosnin në atë qytet të mrekullueshëm.

Westminster Council - Londër

Në një ditë prilli të vitit 2012, bashkë me sekretaren e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Dr. Xhoana Papakostandini, u ngjitëm me ashensor deri në katin e 14-të, të zyrave të Këshillit Bashkiak të Westminster-it, që është bashkia qendrore e Londrës. Ky organ i pushtetit lokal administron qendrën e qytetit, ku janë të vendosura institucionet kryesore të vendit - Mbretëria, Parlamenti dhe Qeveria.

Sekretari i Kryebashkiakes së Qytetit, zonjës Susan Burbridge, na priti me shumë ngrohtësi

dhe mirësjellje. Ai madje na bëri një tur visual rreth e rreth atij kati të lartë aq sa pamë e soditëm shumë prej mrekullive të këtij qyteti magjik. Me shpjegimet e tij ai na kënaqi shumë, sado që neve mezi prisnim të takonim kryetaren e nderuar, me të cilën e kishim takimin. Që andej në të gjitha anët e atij salloni të gjerë shiheshin pjesë të ndryshme fantastike të Londrës. Pamja e parë ishte ajo e Pallatit Mbretëror Buckingham, Kulla e Orës së Madhe, e njohur me emrin Big Ben, Parlamenti Britanik, Abacia Westminster, Foreign Office, më tej Lumi Tames dhe "Syri i Londrës". Më larg, po në atë drejtim shfaqeshin ndërtesat prej xhami të Distriktit Financiar dhe ajo më e famshmja, që njihet me emrin Fisheku. Në drejtim të Viktorias dukeshin një seri ndërtesash viktoriane dhe gjeorgjiane, të bardha me kolona para dyerve.

Takim me zonjën Susie Burbridge - Lord Mayer e Westminster – Londër.

Ora e takimit me zonjën Burbridge kishte kaluar ndërsa ajo nuk dukej, gjë që nuk ndodhte me anglezët kurrë, sidomos kur shkon në zyrën

e tyre. Pas mëse pesëmbëdhjetë minutash vonesë, ky merak i yni u shua sapo dha ballë në derë një zonjë flokëthinjur, me syze, shumë e mbajtur dhe e bukur, ndonëse dukej se mbi të rëndonin mbi 60 vite. Rreth qafës mbante gjerdanin e artë të Kryetares së Bashkisë së Westminister-it, një nga emrat më të njohur në botë. Ajo na buzëqeshi aq ëmbël, sa në çast m'u duk sikur këtë person nuk po e shihja për herë të parë, dhe na ftoi të futeshim në zyrën e saj. U ulëm sipas protokollit dhe rregullave të tyre. Ajo pasi më tregoi se sa e bukur ishte puna e Lord Mayer, po ashtu më tregoi edhe si zgjidhej ky post, i cili kishte në themel besimin e dhënë nga vet Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II. Susie na tregoi për këshillin, këshilltarët, se si ata zgjidheshin dhe e zëvendësonin njëri tjetrin çdo vit, çfarë përgjegjësish mbartnin, etj, etj. Në disa minuta mësova shumë gjëra për funksionimin e pushtetit vendor në Britani. Megjithëse këto shpjegime ishin shumë interesante dhe ishte shumë mirë për mua që t'i dija, çështja për të cilën unë isha aty kishte krejt objekt tjetër. Krijova përshtypjen se Susie po e

largonte vëmendjen time nga ajo, për të cilën isha aty, mbase edhe me qëllim.

Ekspresive siç ishte, e gjallë, e shprehur shumë bukur, me një fjalor aq të zgjedhur, shoqëruar me gjeste shumë fine aristokrate, ajo na mbajti gati 15 minuta me rrëfime të tilla. Kur më dha mundësinë të flisja, unë e falenderova për kohën që më vuri në dispozicion, e falenderova për shpjegimet e vyera për njohjen e atij qyteti dhe të pushtetit vendor si ky në Westminster, pastaj dola menjëherë në "temë".

"Sivjet vendi im feston 100-vjetorin e pavarësisë së shtetit të vet, i thashë asaj. Janë duke u bërë përgatitje të mëdha për këtë festë, jo vetëm në Shqipëri, por në tërë botën ku ka shqiptarë. Në Britaninë e Madhe kemi një numër mjaft të madh shqiptarësh, por në këtë vend ka shumë pak ose asnjë gjurmë të jetës shqiptare. Njerëz të shquar të këtij vendi e kanë vizituar Shqipërinë që në fillimet e shekullit të 19-të, madje edhe më parë. Vendi juaj ka luajtur një rol të caktuar në historinë e vendit tim. Është koha të kemi një monument këtu. Ai do të jetë monument i Skënderbeut, heroit kombëtar

shqiptar, “Atletit të Krishtit”, luftëtarit të paepur të rezistencës ndaj hordhive osmane”.

Kështu vazhdova t’i shpjegoja për disa minuta me radhë dhe vura re se, ndërkohë që unë po flisja, vëmendja e Susie Burbridge po shtohej deri sa ajo filloi të buzëqeshte me një lloj kureshtje dhe simpatie. Me sa duket, shpjegimi im, përpjekja për ta bërë atë paraqitje sa më përshtypjelënëse deri në bindje të saj, pasioni me të cilin po këmbëngulja nëpërmjet çdo fjale për të marrë një premtim prej saj, e “stepi” atë dhe në një çast më ndërpreu e më tha:

- A është i vendosur diku tjetër ky Skënderbeu juaj përveçse në Shqipëri?
- Po, - i thashë, dhe i tregova Romën, Gjenevën, Detroitin, Shkupin, Prishtinën si dhe shumë zona arbëreshe në anë të ndryshme të Italisë si Piana Degli Albanese, etj.
- Po në Londër, - pyeti ajo, - a dini ju se ku mund të vendoset dhe… në fakt a e dini se sa e vështirë është vendosja e tij?

- Po, - i thashë, - e dimë, në Worwick Square, afër me Ambasadën Shqiptare në Pimlico - Viktoria. Aty është një vend i shkëlqyer. Do të ishim të lumtur ta vendosnim aty.
- Oh, - psherëtiu ajo. Edhe nëse do të kisha dëshirën e tërë botës për këtë, aty nuk e vendosim dot, pasi është nën një plan rishikimi urbanistik dhe do të merrte vite deri sa të miratohej. E keqja është se unë për një muaj e dorëzoj detyrën dhe kaloj si një këshilltare e thjeshtë. Por do të jem në këshill dhe do të ndihmoj me tërë forcat e mia, sado që tani për tani nuk kam ndonjë gjë në mendje. Unë do të jem një mbështetëse e fortë e juaja.
- 100 vjet shtet shqiptar! A nuk është diçka e bukur?! Dhe një monument në Londër, në këtë kohë duket si një dhuratë shumë e mirë. Pas tërë këtyre që më tregove, ia vlen t'iu ndihmoj.

Ajo përsëri na dhuroi një buzëqeshje aq njerëzore dhe aq fisnike dhe na dha të kuptonim

se këtu mbyllej kjo bisedë. Mendova se tërë ato shpjegime për Skënderbeun, pastaj historia jonë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Edward Grey, Bajroni, Hobhuase, Edward Lear e sa e sa udhëtarë të tjerë bënë punën e vet... Kështu, u larguam nga ajo ndërtesë, me shumë fjalë, por jo me aq shumë shpresa.

Takim me David Lloyd - miku i David Smail - it dhe Julio Emerit.

Disa ditë më vonë shkova tek një miku i shquar i Shqipërisë, zoti David Lloyd. Ai ishte i njohur i Kryeministrit Berisha dhe ky i fundit më kishte këshilluar ta takoja. Ai ishte një njeri dashur, por shumë ironik, këpuste nganjë thënie të fortë angleze, pastaj qeshte e qeshte vet. Më nxori një gotë me whiskey përpara dhe më pyeti për punën dhe çfarë kisha ndërmend të bëja për 100-vjetorin e pavarësisë. Pasi i tregova për shumë projekte, që kisha në kokë, i fola edhe për dëshirën për të vendosur një bust të Skënderbeut në Londër dhe si rrëshqitazi i tregova edhe për hapin e parë, që kisha bërë, d.m.th. për takimin me Susie Burbridge.

- Hahaha, - shpërtheu ai në të qeshura. - Susie? Susie Burbridge!?
- Po, - i thashë, - Susie, Lord Majoresha e Westminster-it.

Pastaj më pyeti çfarë kishim biseduar dhe pasi i shpjegova në përgjithësi ai qeshi dhe papritmas, mori telefonin, formoi ca numra dhe në anën tjetër të linjës u dëgjua një zë i ëmbël gruaje.

- Po, i dashur David, më thuaj, - u përgjigj ajo.
- Susie, ku gjendesh ti? - e pyeti Davidi.
- Në shtëpi, - u duk se tha zonja.
- Eja tek unë sa më parë, të lutem!
- Mirë, - tha ajo.

Pas rreth 15 minutash, në derë u shfaq Susie Burbridge. Ajo për një çast shtangu.

- Uau, po ju këtu? Çfarë suprize! David, a është koincidencë, apo e keni sajuar ju këtë takim?
- Është edhe koincidencë por edhe desha ta takonit mikun tonë nga Shqipëria, në shtëpinë time dhe të vazhdoni bisedën për Skënderbeun.
- Oh, Zot i Madh, Skënderbeu! Ai i ka shpëtuar shqiptarët dhe Europën nga Turqit.

Pas kësaj që tha shumë seriozisht, shpërtheu në të qeshur dhe vazhdoi:

- Ndërsa mua më shpëtoi nga një vend parkimi për makinën e Ambasadës(!)
- Çfarë parkimi, Susi, a e di për çfarë po flasim? - ia ktheu Davidi.
- Po, David, kur më erdhi në zyrë zotëria, gati sa nuk desha ta takoja. Jam mësuar që tërë shefat e misioneve diplomatike në Westminster vijnë dhe kërkojnë vende parkimi për makinat e stafit të tyre. Thashë se të njëjtën gjë do të bënte edhe ky. Kur e pashë që nuk më kërkonte vend-parkimi, u lehtësova, mora një leksion historie, madje kam kërkuar dhe lexuar edhe shumë gjëra të tjera në internet dhe kam mësuar për Skënderbeun.
- Epo na duhet ta ndihmojmë ta vendosim atë bust këtu në Londër, si thua? - ia ktheu Davidi. Unë kam një vend në mendje. Këtu në Bayswater, në kufi me Notting Hill, është një vend shumë i mirë për atë monument. Është Lady Samuel Square. E di çfarë? Marko, iu drejtua ai një njeriu që e kishte në shtëpi, merr Susin dhe Malin dhe shkoni e shikojeni. Pastaj ejani prapë këtu.

Tek sheshi Lady Samuel Square – Bayswater

Kështu ishte sheshi përpara se të vendosej busti i Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.

Bashkë me zonjën Burbridge dhe zotëri Marko Maciolinin u nisëm dhe shkuam tek ai shesh. Ishte mjaft i përshtatshëm për të vendosur bustin. Një shesh i gjelbëruar mjaft mirë, me shumë bimë dekorative, në një kryqëzim rruge me shumë lëvizje, me një mur

prapa në sfond të mbuluar me bimë kacavjerrëse.

Sheshi gjendej në adresën *113 Inverness Terrace, London W2 6JH*. Ai ishte një vend shumë i pranueshëm dhe i bukur. Kisha pyetur se si ishin vendosur shumë monumente njerëzish të huaj nëpër Londër dhe sa kishin kushtuar? Çmimi për vendosjen e tyre ishte marramendës. Për shembull, shtatorja e Nelson Mandelës e vendosur përpara Abacisë së Westminister-it dhe Parlamentit në qendër të Londrës kishte kushtuar 5 milion stërlina vetëm për ta lejuar vendosjen e tij aty. Kostoja e monumentit ishte llogari tjetër dhe po kaq në mos më shumë kishte kushtuar vendosja aty afër e shtatores së Mahatma Ghandit, themeluesit të shtetit modern të pavarur të Indisë.

Kështu u kthyem përsëri tek shtëpia e Davidit. Rrokullisëm nga një gotë whiskey dhe biseduam për mundësinë e marrjes së atij vendi për truall të monumentit të Skënderbeut. Lord Majorja Burbridge na premtoi se do të shihte mundësinë e dhënies së atij vendi pasi të sigurohej mbi pronësinë e tij, lobimin që do të

bënte me anëtarët e Këshillit Bashkiak e sidomos me këshilltarin Robert Davis, pasardhës i saj, si dhe më pas hapat, që do të merreshin për ta përfunduar atë projekt në kohën e duhur, do me thënë me datën 28 nëntor 2012. Një ndër gjërat që duheshin bërë ishte të merrnin miratimin me nënshkrime të më shumë se dy mijë banorëve, që jetonin në atë zonë dhe e shihnin bustin çdo ditë dhe që nuk kishin kundërshtim për vendosjen e tij.

Patricia Nugge - Koleksionistja e njohur e librave për Skënderbeun

Në Londër jeton një zonjë angleze e quajtur Patricia Nugee, koleksioniste e njohur e librave të Skënderbeut. Ajo njihet si një nga koleksionistët që ka më shumë libra për Skënderbeun, të cilat i ka grumbulluar që kur ishte një punonjëse e re e një biblioteke në Londër. Patricia ishte frymëzuar gjatë vizitës, që kishte bërë në Shqipëri në vitet ’70 të shekullit të kaluar dhe i kishte kushtuar shumë kohë mbledhjes, ruajtjes dhe ekspozimit në shumë vende të botës të këtyre librave jo vetëm në

Londër, por edhe në Barcelonë, Madrid, Romë, Prishtinë, Tiranë, etj. Patricia insisonte që busti të vendosej vetëm dhe vetëm pranë ambasadës në sheshin Warwick. Por aty ishte e pamundur dhe kur i thashë se kam shpresë ta vendos në Bayswater, ajo kundërshtoi. Në një takim me të i thashë se, është e natyrshme që unë do dëshiroja desha që busti i Skënderbeut të vendosej pranë atij të Çurçillit, por unë i di forcat tona. Nëse ke dikë me të cilin ju loboni, më thuaj të shkojmë ta takojmë. Ajo vet nuk kishte një të tillë.

Ndërkohë në Shoqatën Anglo - Shqiptare bëheshin po ashtu përpjekje për të ndihmuar në vendosjen e bustit. Presidenti i Nderit, Profesor Noel Malcolm, kryetari i shoqatës, ish Ambasadori Britanik në Tiranë, Stephen Nash, përkthyesi i Ismail Kadaresë John Hodgson, studiuesi dhe diplomati i Republikës së Kosovës, Bejtullah Destani, Konsullja e Nderit e Republikës së Shqipërisë në Oxford, zonja Bryony Bethel, të gjithë bënin përpjekjet e tyre. Kjo u bë një temë e preferuar bisede me të gjithë dhe në çdo rast. Tani ajo ide dashamirëse e të gjithë këtyre po merrte formën e vet. Shumica

prej tyre e mbështetën idenë e vendosjes së bustit në Bayswater.

Debat me Miranda Vicker.

Që prej shumë vitesh përpara se të emërohesha në Londër, kisha dëgjuar për një emër të quajtur Miranda Vicker. Ajo ishte një majtiste e egër dhe një shkrimtare, veprat e së cilës rreth Shqipërisë janë të mbushura plot e përplot me pasaktësi shkencore dhe influenca politike të majta. Ajo kishte dëgjuar për nismën tonë për vendosjen e bustit të Skënderbeut dhe një mbrëmje, pas një aktiviteti në ambasadë më tha:

- A mund t'iu pyes diçka? Vërtet po bëni përpjekje për të vënë në Londër bustin e Skënderbeut?
- Po, - i thashë, - jo pa krenari.
- Po çfarë lidhje ka Skënderbeu me Londrën? - më pyeti ajo.
- Çfarë lidhje ka?! Ka shumë lidhje, - i thashë. - Ai është quajtur Atleti i Krishtit, prej katër Papëve të Romës njëri pas tjetrit, titull që e kanë marrë shumë pak njerëz, ndër ta edhe Janosh Huniadi dhe Luizi i Parë i Hungarisë. Ai u bë në

fakt barriera e fundit e pjesës fundore - perëndimore e Perandorisë Osmane për të mos e kaluar Detin Adriatik. Po mos të ishte ai, që për këtë kauzë sakrifikoi kombin dhe veten e vet, Vatikani mund të kishte xhaminë më të madhe në botë, siç ndodhi me Hagia Sofia në Kostandinopul në vitin 1453, ndërsa ju ndoshta do të kishit një emër musliman. Pastaj Londra ka aq shumë monumente njerëzish të shquar, të cilët, sikundër Skënderbeu, nuk kanë qenë asnjëherë në Londër.

Në kërkim të modelimit të bustit të Skënderbeut.

Pasi mora një miratim dhe premtim për financimin e bustit nga Tirana (premtim, i cili nuk u mbajt asnjëherë) dhe pasi kisha gjetur edhe truallin ku do të vendosej, fillova të mendoja për veprën, të cilën as që e dija se ku do ta gjeja. Në fillim më erdhi ideja që të vendosnim një kopje të veprës së Odise Paskalit. Kjo ide ra menjëherë, sapo njerëzit që e kishin të

drejtën e autorit na paraqitën një çmim, i cili ishte përtej çdo imagjinate.

Atëherë vendosa të thërrisja dhe ta pyesja artisten e njohur Suzana Varvarica - Kuka, një njohëse dhe kritike e shkëlqyer e artit figurativ, e cila punonte në Galerinë tonë Kombëtare të Arteve. Pasi i shpjegova situatën, ajo më rekomandoi të kontaktoja skulptorin e njohur Kreshnik Xhiku. Ajo më dha të gjitha të dhënat dhe e gjeta këtë të fundit në Washington D.C, në SHBA. Pasi i shpjegova Kreshnikut për nismën tonë, ai më premtoi se do ta bënte me shumë kënaqësi. Tani edhe një problem u zgjidh: Vepra. Por mbetej financimi si problemi kryesor dhe projekti i vend-vendosjes.

Kontributi i Studios Oliver & Hasani.

Për dokumentacionin e projektit të vendosjes së bustit një studio ligjore londineze kërkonte pesë mijë stërlina. Ku do të gjendeshin!? E dija që kishte djem e vajza shqiptare arkitektë në Londër. Dhe ja ku u gjet! Së pari u angazhua studio ligjore Oliver & Hasani drejtuar nga një djalë shkodran i quajtur Naim Hasani. Ai mori

përsipër tërë anën dokumentare dhe ligjore për t'i paraqitur në Bashkinë e Westminister-it.

Si do të emërtohej ai monument?

Ndërkohë që merresha me bustin dhe aksesorë të tjerë, duhej menduar edhe për emërtimin e tij. Në dukje kjo ishte gjëja më e thjeshtë, por në fakt kjo kishte rëndësi të posaçme. Teksti duhej të gdhendej në piedestal: E mendova gjatë e gjatë. Ta identifikoje me Krishtërimin siç kishin bërë Papët e Romës kur e quajtën "Atlet i Krishtit", por pata frikë se nxisja reagimin e ndonjë fanatiku islam, të cilët gjenden me shumicë në Londrën kozmopolite. Por edhe pa një emërtim shumë përfaqësues të kohës kur jetoi ai, nuk do të kuptohej nga vizitorët dhe kalimtarët. Pasi u konsultova me shumë miq të ditur, madje edhe akademikë, mendja më shkoi tek miku im Visar Zhiti. I shkrova Visarit një email dhe iu luta të më ndihmonte për emërtimin. Pasi e diskutuam gjatë me telefon dhe me postë elektronike, arritëm në një mendim të përbashkët. Le të ishte

diçka që me pak fjalë të thoshte shumë, menduam të dy. Dhe vendosëm këtë diçiturë:

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu
1405 -1468
Heroi i Paepur Kombëtar Shqiptar
Mbrojtës i Qytetërimit Perëndimor.

Na u duk se ishte ide shumë e mirë. Tani duhej përkthyer në anglisht në një formë sa më shprehëse, konçize, të pranueshme dhe përshtypje-lënëse. Dhe ja ku doli edhe diçitura:

George Kastrioti - Scanderbeg
1405 - 1468
Invincible Albanian National Hero
Defender of Western Civilization

Më bukur se kaq nuk ka ku të shkojë, thashë me vete. Më kuptimplotë se kaq nuk mund të ishte. Duke ditur se shenjti mbrojtës i anglezëve ishte *George* dhe mbretërit e atij vendi shumica "*George*" ishin, por edhe pse në literaturën perëndimore, emri i parë i heroit tonë

Gjergj është George, vendosëm ta shkruajmë atë si në anglisht.

Piedestali - Përparimi dhe Kristalja nga Grupi "4mgroup" dhe Isuf Margjeka.

Kriteret e vendosjes së një monumenti në Londër janë tej mase rigoroze: Përmasat, baraslargësia me objektet e tjera, pamshmëria nga vizitorët, profili dhe drejtimi i vështrimit të bustit, mjedisi rrethanor, lulet dhe gjelbërimi, lartësia mbi tokë, largësia nga fasada i bustit të heroit tonë duheshin respektuar një më një. Për këtë u angazhua Grupi "4mgroup" i themeluar nga arkitekti shumë i njohur nga Prishtina, Ingj. Përparim Rama si dhe e shoqja, zonja Kristale Rama - Ivezaj, një shqiptaro - amerikane e lindur në Detroit me prindër shqiptarë nga Mali i Zi, editore gazete dhe intelektuale e shquar. Ata dhe Besiana, (nga Tropoja edhe ajo) e morën përsipër tërë punën përgatitore dokumentare për vendosjen e piedestalit dhe më pas të vet bustit.

Tani mbetej të përgatitej terreni dhe të ndërtohej piedestali. Pasi e diskutova me shumë

të njohur e gjeta edhe atë. Ishte Isuf Margjeka, një djalë i mrekullueshëm tropojan.

"E bëj unë", më tha! "E kam për nder."

Dhe kështu bëri. E ndërtoi piedestalin dhe e bëri gati për ditën e përurimit. Tani mbetej pjesa finale.

Odiseja e modelimit, derdhjes dhe transportit të bustit deri në Londër.

Dita e përurimit të bustit ishte caktuar: 28 Nëntor 2012, në orën 13.00, edhe pse busti ende nuk ishte bërë. Deri më 5 nëntor ne kishim vetëm premtime, por nuk kishim bust, as fond të disbursuar, as para për të paguar për lejen nga Këshilli Bashkiak i Westminster-it. Problemi ishte se nuk kishim fond as për skulptorin, që të modelonte veprën dhe aq më keq as për fonderinë, që do ta derdhte në bronx dhe as për transportin nga Tirana në Londër. Me një përpjekje të jashtëzakonshme arrita të siguroja premtimin për fondin, që do t'i jipej bashkisë, po ashtu edhe autorit. Por ndërsa me bashkinë isha në negociata që fondi të transferohej fill pas vendosjes së bustit, autori, Kreshnik Xhiku, nuk

gjente fonderi në Tiranë, e cila të mund ta derdhte bustin në gizë apo në bronx pa i dhënë paratë në dorë. Tre të tilla punonin në Tiranë, por asnjëra nuk pranonte. Më pas do të ndiqej ecuria e derdhjes së bustit dhe lucidimit të tij, që kërkonte edhe kjo kohën e vet.

Financimi dhe pronësia mbi Bustin e Skënderbeut në Londër.

Mesditën e 5 nëntorit 2012 skulptori, Kreshnik Xhiku, më thirri në telefon nga Tirana dhe më tha që, nëse busti nuk futej në proces fonderie po atë ditë, nuk arrihej të bëhej gati për t'u vendosur në Londër më 28 nëntor. Problemi ishte shumë serioz. Unë, ndonëse njihesha mirë me drejtuesin e Ministrisë së Kulturës së asaj kohe, i cili më kishte thënë që: "*veç arrije ta vendosësh bustin, se për çdo gjë jemi gati të mbështesim*", nuk e gjeja të realizuar këtë premtim. Atëherë, çfarë duhej të bëja? Të dorëzohesha? Jo! Ky nuk ishte opsion!

Në pamundësi për ta zgjidhjur këtë çështje me shtetin, i kërkova një mikut tim në Tirane (AP) një borxh prej tetë mijë eurosh me të drejtë

kthimi në një afat pak të gjatë dhe me shpresë se Ministria e Kulturës do ta konsideronte premtimin e dhënë. Kështu edhe kjo çështje u zgjidh. Skulptori i mori po atë ditë paratë dhe bëri pagesën në fonderi. Disa kohë më vonë e ktheva borxhin nga buxheti im, cent për cent, nga buxheti im modest personal. As qeveria shqiptare e asaj kohe dhe aq më pak pasardhësja e saj nuk e pagoi kurrë atë faturë. Në këtë aspekt, ai bust edhe sot e kësaj dite qëndron krenar në Londër, por është pronë e familjes Berisha, dhe do t'i trashëgohet me testament pasardhësve të mi. *Askush nuk ka të drejtë të marrë pronësinë deri sa të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 697, datë 16.8.2013 për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Mbulimin e Shpenzimeve për Realizimin në Bronx të Bustit.*

Sipas një informacioni që mora më vonë, ai bust nuk gjëndet në inventarin e veprave të artit të Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë. Në Tiranë. Ndërkohë dosja e të tërë dokumentacionit gjëndet në arkivën e Ambasadës Shqiptare në Londër.

Arritja e Bustit në Londër, 27 Nëntor 2012. Skënderbeu “bujtës” tek Isufi.

Me vullnet dhe përkushtim çdo gjë arrihet. Kështu në mbrëmjen e datës 27 nëntor 2012 busti arriti në Aeroportin Gatewick në Londër. Procedura e çdoganimit dhe futjes së kësaj vepre arti ishte një praktikë tjetër plot me burokracira. Edhe për atë i kishim marrë të tëra masat, që mos të kishte pengesa. Aty nga ora njëmbëdhjetë e natës, çdo gjë u rregullua. Busti tanimë ishte në tokën angleze. Isuf Margjeka, i cili kishte bërë piedestalin, shkoi në aeroport për ta transportuar atë. Ai më bëri telefonatën e sihariqit se Skëndërbeu më në fund kishte arritur në Londër.

- Skënderbeu erdhi dhe unë tani sapo e vura në makinën time, - më njoftoi ai në telefon. - Por më thuaj çfarë duhet të bëj tani? Ku duhet ta mbaj sonte unë atë? - më tha ai, si në të qeshur.
- Oh, Isuf, po merre musafir në shtëpi! A ka nder më të madh se ta kesh patur Skënderbeun bujtës në shtëpinë tënde, qoftë edhe një natë?
- Ke të drejtë, - më tha.

Dhe kështu bëri. Me kamionetën e tij, ai e mori atë atë natë në shtëpinë e vet. Ndoshta ai u bë i pari shqiptar, që një natë e kishte patur musafir Heroin tonë Kombëtar. Ai edhe sot e kësaj dite e mban si një ndër gjërat më të rëndësishme, që i kanë ndodhur në jetën e tij.

Vendosja dhe Përurimi i Bustit - 28 Nëntor 2012

Më 28 nëntor 2012, në orën 8 të mëngjesit busti u lëshua në zhlepin e vet të piedestalit dhe u mbështoll me Flamurin Kombëtar Shqiptar. Qysh në atë orë qindra shqiptarë filluan të festojnë, të kërcejnë e të këndojnë. Në një moment, Policia Metropolitane e Londrës erdhi dhe më kërkoi të shpjegoja se çfarë po ndodhte, pasi kishte pengesë të trafikut. Pasi iu shpjegova më thanë: “Ne do të devijojmë trafikun deri sa ju të mbaroni. Vazhdoni për aq kohë sa dëshironi ju”.

Në orën 13.00 velloja e kuqe me Flamur Kombëtar Shqiptar u hoq dhe ai u shfaq krenar në sheshin Lady Samuel, në mes të Londrës.

Unë kisha vajtur që herët bashkë me punonjësit e ambasadës si dhe zonjën time, Donika. Kur busti u lëshua mbi piedestalin e vet ndjeva një gëzim të jashtëzakonshëm. Kishim arritur diçka të madhe. Ai bust m’u duk se pasqyronte në fytyrën e tij epike, burrërore, në thjeshtësinë e tij të cilën skulptori e kishte trajtuar me kujdes dhe me qëllim për ta bërë sa më tokësor, sa më njerëzor, duke ruajtur dhe vënë në pah forcën e tij burrërore, tërë karakterin e popullit tim. Kryelart, krenar, me

sy të thellë që vështrojnë larg, me tipare të thella prej burri, me ashpërsinë e luftëtarit të paepur, me një mjekër të shkurtër me shtëllunga të vogla, aspak të ekzagjeruara sikundër në disa buste të tjera, ku për arsye që nuk i shpjegoj dot teprohet me këtë element, me një qafë të gjatë mbi një trup solid, të fortë e burrëror, ai qëndroi sfidant në atë shesh. Ai është i pari dhe i vetmi monument shqiptar deri më sot në Britaninë e Madhe. Por është edhe një ndër monumentet më dinjitoze dhe përfaqësuese të ndonjë figure apo heroi kombëtar të ndonjë populli europian në atë qytet - Galeri Arti në Natyrë.

Fjalimi para Bustit më 28 nëntor 2012

Në fjalimin përurues fola me një pasion dhe emocion si kurrë ndonjëherë. Në fakt isha gati si një kufomë e pakallur prej dy operacioneve shumë të rënda, që kisha kaluar gjatë nëntorit, pikërisht në atë kohë kur po merresha edhe me bustin. Ishte dëshira për të vënë atë bust në atë përvjetor në atë vend, për ata njerëz që kishin ardhur për inaugurimin që tejkalonte çdo gjë. Sipas shënimeve të mia, ndër të tjera, thashë:

“Prej sot, këtu në Bayswater neve do të kemi simbolin tonë kombëtar, Bustin e Skënderbeut, vepër e skulptorit Kreshnik Xhiku.

Jam krenar që përfaqësoj në këtë ditë historike të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, vendin tonë të dashur, Shqipërinë. Ju përfaqësoj juve, që jeni komuniteti më i ri dhe më me perspektivë në këtë vend, juve që i jepni nder këtij vendi dhe vendit prej nga keni ardhur nga çdo truall etnik shqiptar i Ballkanit.

“Prej sot, ky vend do të jetë vendi juaj, tempulli juaj i nderit kombëtar, do të jetë faltorja juaj. Duajeni, respektojeni, kthehuni herë pas here, frymëzohuni dhe reflektoni për identitetin tuaj!

“Bëhuni britanikët më të mirë të këtij vendi, por jeni edhe shqiptarët më patriotë në botë!

Dhe do të jeni njerëzit më fisnikë të këtij globi.

“Dhe do të jeni njerëzit më të mirë të këtij vendi mik e të bekuar!

“Rrofshi ju!

Rroftë emri dhe vepra e Skënderbeut!

Rroftë Shqipëria!

Rroftë Britania e Madhe!

Zoti e ruajtë mbretëreshën!”…

Bacë u kry.

THIS GARDEN
is dedicated to
BEATRICE VISCOUNTESS SAMUEL
who was born, lived and died
in this neighbourhood

George Kastrioti-SKANDERBEG
1405 - 1468
INVINCIBLE ALBANIAN NATIONAL HERO
DEFENDER OF WESTERN CIVILIZATION

Kastrioti-SKANDERBEG
1405 - 1468

George Kastrioti -SKANDERBEG
1405 - 1468
INVINCIBLE ALBANIAN
DEFENDER OF WESTERN

George Kastrioti-SKANDERBEG
1405 - 1468
INVINCIBLE ALBANIAN NATIONAL HERO
DEFENDER OF WESTERN CIVILIZATION

Giorgio Castriota SKANDERBEG
1405 – 1468
Atleta Christi
impavido Difensore
della Civiltà Occidentale
Montecilfone, 04. 08. 2013